



Pranuar / Dorezuar Puniljenç/Prodato Received/Delivery	30-03-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHICK	1727/2022		111



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

Nr. 29 /2022  
Datë:30.03.2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2. 4 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, si dhe nenin 2 paragrafi 5 të Rregullores Nr.02/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.04/2018, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*Këshilli*) në mbledhjen e pestë (V) të mbajtur më datë 30.03.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Raporti i Kolegjit të Këshillit lidhur me vlerësimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për vitin 2020 në Ministrinë e Infrastrukturës.
2. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës obligohet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandime është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit,

**Jeton KOÇA**  
Kryetar i Këshillit

**Vendimi i dërgohet:**

- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë së Infrastrukturës,
- Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Infrastrukturës,
- Arkivit të Këshillit.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dërrëzuar Punëdhënës/Pradato Received/Delivered	30.03	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSHCK	1727/2022		1121	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE**  
**LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2020**

**NË**

**MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS**

**Prishtinë, 2022**

<b>PËRMBAJTJE</b> .....	2
HYRJE.....	3
FUNKSIONI I MONITORIMIT.....	4
OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....	5
FUSHA E MONITORIMIT.....	6
RAPORTI I MONITORIMIT NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS.....	7-21

## HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tutje referuar si Këshilli*) është institucion i pavarur në kuadër të Kuvendit që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Për mbikëqytjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore:

- *shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil;*
- *monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civile.*

Këshilli, funksionet dhe përgjegjësitë themelore i ushtron në pajtim me:

- *Kushtetutën e Republikës së Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë;*
- *Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;*
- *Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;*
- *Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil;*
- *Rregulloren Nr.05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

## FUNKSIONI I MONITORIMIT

Këshilli, krahas funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave të nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil, ushtron edhe funksionin e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Këtë funksion Këshilli e ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe dispozitat e Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Këshilli, përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike, mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil me qëllim të krijimit të një administratë publike profesionale dhe efektive, sipas standardeve me të mira evropiane.

Funksionin e monitorimit, Këshilli e ushtron përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli, në procesin e monitorimit të institucioneve të administratës publike përgatit raport me të gjetura dhe rekomandime dhe nxjerr vendim, të cilin së bashku me raport ia dërgon institucionit përkatës. Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit.

## OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Monitorimi i institucioneve të administratës publike ka për qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

## FUSHAT E MONITORIMIT

Këshilli, me qëllim të ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e monitorimit.

Sipas Rregullores Nr.04/2018 për procedurën e monitorimit në institucionet e administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, fushat të cilat monitorohen nga Këshilli janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat lidhur me përfaqësimin etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale apo është i dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Ngacmimet Seksuale;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Monitorimin e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

## RAPORT I MONITORIMIT LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVILË NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS PËR VITIN 2020

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Ministrinë e Infrastrukturës për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga zyrtaret përgjegjës të institucionit përkatës, përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës monitoruese me datë 11.02.2022, në prezencë të Udhëheqësit të Njësisë për Burime Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të dokumenteve relevante (kopje), si në vijim:

- Rregulloren (QKR) Nr.16/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Infrastrukturës;
- Organogramin e Ministrisë së Infrastrukturës;
- E-mailin e datës 23.11.2020 nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore për Drejtoret e Departamenteve për vlerësimin e nëpunësve civilë;
- Akt emërimin e nëpunësit për vendin e punës “Zyrtar i Lartë i Buxhetit” i datës 17.01.2012;
- Vendimin e datës 23.04.2021 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit për nëpunësin “Zyrtar i Lartë i Buxhetit” si dhe dëshmia për kompensimin e pagës me rastin e pensionimit;
- Certifikatën e Marrëdhënies së punës për nëpunësin “Zyrtar i Lartë i Buxhetit”, e datës 23.04.2021;
- Akt emërimin e nëpunëses për vendin e punës “Zyrtare për Arkiv 2”;
- Formularin e vlerësimit për nëpunësen në vendin e punës “Zyrtare për Arkiv 2”;
- Kërkesën e pushimit vjetor për nëpunësen në vendin e punës “Zyrtare për Arkiv 2”;
- Kërkesën e pushimit mjekësor për nëpunësen në vendin e punës “Zyrtare për Arkiv 2”;
- Akt emërimin e ankueses në vendin e punës “Asistente Administrative”;
- Kërkesën për pushim vjetor të nëpunëses për vendin e punës “Asistente Administrative”;
- Formularin i vlerësimit për nëpunësen në vendin e punës “Asistente Administrative”;
- Vendimin e datës 09.07.2020 për themelimin e Komisionit Disiplinor;
- Vendimin e datës 31.08.2020 për Themelimin e Komisionit Disiplinor;
- Vendimin e datës 12.10.2017 për lejimin e pezullimit i dakorduar për nëpunësin në vendin e punës “Udhëheqës i Divizionit të Transportit Rrugor dhe Hekurudhorë të Udhëtarëve”;
- Akt emërimin e nëpunësit në vendin e punës “Udhëheqës i Divizionit të Transportit Rrugor dhe Hekurudhorë të Udhëtarëve” e datës 18.05.2013;
- Kërkesën e datës 18.09.2020 për udhëtim zyrtar jashtë vendit për nëpunësin civil për vendin e punës “Drejtor i Departamenti për Menaxhim për Buxhetit”;
- Vendimin e datës 17.04.2020 për caktim të ushtruesit të detyrës;
- Akt emërimin e datës 01.12.2011 për vendin e punës “Inspektor i Infrastrukturës Rrugore”
- E-mailin e datës 23.04.2021 nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore për paraqitje të rastit në Komision Disiplinor për shkak të mungesave të paarsyeshme të punës;
- Njoftimin e datës 18.01.2021 me numër të protokollit 368;
- Njoftimin e datës 21.12.2020 me numër të protokollit 10133;
- Akt emërimin e nëpunësit i sistemuar në vendin e punës “Zyrtar i Lartë Ekzekutiv” i datës 18.11.2016;
- Vendimin e datës 11.12.2020 për caktim të zëvendësuesit;
- Vendimin e datës 09.01.2020 me numër 142/2020 për caktimin e anëtares për Komision për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;



- Vendimin e datës 28.01.2019 me numër 752/2019 për emërim të anëtares së Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Plotësim ndryshimi i vendimit me numër 5015 i datës 09.07.2020 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Vendimin e datës 13.02.2020 me numër 1991 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Vendimin e datës 05.08.2020 me numër 5711 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Akt emërimi i ankuesit në vendin e punës “Teknik i Komunikacionit Rrugor” i datës 11.01.2016;
- Vendimin e datës 06.03.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Akt emërimin e datës 19.07.2019 i nëpunëses e sistemuar në vendin e punës “Zyrtare për Buxhet dhe Financa”;
- Formulari për vlerësimin e punës provuese për nëpunësen në vendin e punës “Zyrtare për Buxhet dhe Financa” e datës 19.07.2019;
- Formulari për vlerësimin e rezultatit të punës për vitin 2020 për nëpunësen në vendin e punës “Zyrtare për Buxhet dhe Financa”;
- Akt emërimin e datës 01.08.2019 i nëpunëses e sistemuar në vendin e punës “Zyrtare e Administrative”;
- Ndryshim dhe plotësimin e datës 26.08.2019 të akt emërimin për nëpunësen e sistemuar në vendin e punës “Zyrtare e Administrative” në vendin e punës “Zyrtare e Prokurimit”;
- Formularin për vlerësimin e punës provuese e datës 09.11.2020 për nëpunësin e sistemuar në vendin e punës “Zyrtare e Prokurimit”;
- Akt emërimin e datës 11.01.2016 për nëpunësin në vendin e punës “Zyrtar për Transport Rrugor”;
- Kërkesën e datës 16.01.2020 me numër 406 lidhur me planin vjetor të trajnimit të nëpunësve civilë;
- Vendimin e datës 24.12.2020 me numër 10312 për pushim e lehonisë;
- Vendimin e datës 21.12.2020 me numër 10159 për pushim të lehonisë;
- Vendimin e datës 06.01.2020 për ndërprerje të marrëdhënies së punës me vendim të një anshëm-dorëheqje;
- Deklaratën e datës 30.12.2019 për dorëheqje e nëpunësit në vendin e punës “Zyrtare për Siguri në Qarkullim Rrugor”;
- Raporti i prezencës në punë për periudhë 01.02.2020-29.02.2020 dhe 01.10.2020-31.10.2020;
- Vendimin e datës 15.07.2020 me numër 5225 për transfer të përkohshëm;
- Vendimin e datës 02.10.2020 me numër 7002 për transfer të përkohshëm;
- Vendimin e datës 24.05.2018 me numër 4785 për caktimin e ushtrueses së detyrës;
- Akt emërimin e datës 01.01.2011 për nëpunësen në vendin e punës “Udhëheqëse e Divizionit të Burimeve Njerëzore”;
- Vendimin e datës 07.02.2019 me numër 1280 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Akt emërimin e datës 30.06.2014 i nëpunësit në vendin e punës “Asistent i Sekretariatit të Këshillit për Siguri në Komunikacion Rrugor”;
- Vendimin e datës 16.11.2017 me numër 8731 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Akt emërimin e datës 02.05.2012 të nëpunësit “Zyrtar për analiza dhe statistika”;
- Vendimin e datës 04.09.2019 me numër 8397 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Akt emërimin e datës 01.05.2012 i nëpunësit në vendin e punës “Zyrtar i Projekteve për Rrugë”;
- Vendimin e datës 09.12.2020 me numër 9765 për caktimin e zëvendësimit;

- Akt emërimi e datës 10.11.2012 të nëpunësit i sistemuar në vendin e punës “Inxhinier i Elektros”;
- Vendimin e datës 23.04.2020 me numër 3452 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Akt emërimin e datës 20.05.2019 i nëpunësit në vendin punës “Zyrtar Administrativ”;
- Vendimin e datës 11.07.2019 me numër 7394 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimin e datës 24.04.2018 me numër 3735 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Akt emërimin e datës 17.01.2013 për nëpunësen në vendin e punës “Udhëheqës i Divizionit të Transportit Hekurudhor dhe Tokësor i Mallrave dhe Mallrave të Rrezikshme”;
- Vendimin e datës 11.12.2020 me numër 9907 për caktimin e zëvendësuesit;
- Vendimin e datës 05.06.2018 me numër 5238 për caktimin e ushtrueses së detyrës;
- Akt emërimin e datës 04.04.2012 e nëpunëses në vendin e punës “Zyrtare e Lartë e Personelit”;
- Vendimin e datës 17.03.2015 me numër 1083/2015 për caktimin e ushtruesit të detyrës;
- Akt emërimin e datës 18.01.2012 për nëpunësin në vendin e punës “Asistent Administrativ”;
- Vendimin e datës 11.01.2021 me numër 147 për caktimin e zëvendësuesit;
- Vendimin e datës 13.12.2018 me numër 11638 për caktimin e ushtrueses së detyrës;
- Akt emërimin e datës 01.06.2015 i nëpunëses në vendin e punës “Zyrtare për Transport Tokësor”;
- Vendimin e datës 02.06.2020 me numër 4043 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit;
- Vendimin e datës 24.11.2020 me numër 9333 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit;
- Vendimin e datës 05.10.2020 me numër 7073 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit;
- Vendimin e datës 08.04.2020 me numër 3265 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit;
- Vendimin e datës 08.04.2020 me numër 3266 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit;
- Vendimin e datës 21.01.2020 me numër 535 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit;
- Vendimin e datës 02.06.2020 me numër 4041 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit;
- Vendimin e datës 07.08.2020 me numër 5781 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 07.02.2020 me numër 1762;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 11.02.2020 me numër 1894;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 07.02.2020 me numër 1751;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 04.02.2020 me numër 1618;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 20.02.2020 me numër 2178;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 23.12.2019 me numër 13490;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 06.02.2020 me numër 1701;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 18.12.2019 me numër 13311;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 20.02.2020 me numër 2172;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 04.02.2020 me numër 1612;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 23.07.2020 me numër 5447;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 28.05.2020 me numër 3929;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.07.2020 me numër 4795;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 28.07.2020 me numër 5572;

- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 14.07.2020 me numër 5169;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 14.07.2020 me numër 5199;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 06.08.2020 me numër 5739;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 09.07.2020 me numër 5062;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 09.07.2020 me numër 5064;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 17.01.2020 me numër 426;
- Vendimin për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për shkak vdekjes së nëpunësit i datës 31.12.2020 me numër 10516 si dhe kompensimi i familjes me rastin e vdekjes;
- Vendimin e datës 17.11.2020 me numër 9164 për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil-vdekja e nëpunësit si dhe kompensimi i familjes.

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e monitorimit të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

## 1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Ministrinë e Infrastrukturës më datë me 11.02.2022, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren (QRK) Nr.16/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Infrastrukturës të vitit 2015. Në këtë institucion kanë qene të punësuar dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë (266) nëpunësve civil, ndërsa në vitin 2020 kanë qenë njëzet e pesë (25) pozita të lira.

- Gjatë vizitës monitoruese, Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar dosjet e nëpunësve civil për pozitën “Zyrtar i Lartë për Buxhet”, “Zyrtare për Arkiva 2”, “Asistente Administrative”, dhe “Udhëheqës i Divizionit të Transportit Rrugor dhe Hekurudhor të Udhëtarëve” dhe në bazë të vlerësimeve nuk ka gjetur shkelje pasi që dosjet e personelit janë të ruajtura dhe të kompletuara sipas Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civil, dhe Rregullores (MPB) Nr. 01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore respektivisht në dosje të nëpunësve civilë janë përfshirë të dhënat personale të nëpunësve më përgatitjen profesionale, përvoja e punës, certifikatat e trajnimeve, kërkesat e pushimeve, formularët e vlerësimit të rezultateve në punë dhe formularët e përmbajtjes së dosjeve personale të nëpunësit civil, respektivisht fleta prezantuese.

- **Ushtruesit e detyrës:** Në bazë të informatave të ofruara, është konstatuar që Ministria e Infrastrukturës gjatë vitit 2020 ka pasur të caktuar shtatëmbëdhjetë (17) pozita me ushtrues të detyrës apo zëvendësues të cilat vazhdojnë tutje.

- Sipas deklarimit të Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Infrastrukturës, është përgatitur lista e deklarimit të statusit të zyrtarëve publikë dhe e njëjta është përcjell në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Rrjedhimisht procesi i deklarimit të statusit të zyrtarëve publikë nuk ka qenë i përfunduar.

Këshilli gjatë shqyrtimit të dosjeve ka konstatuar këtë të gjetur:

**E GJETURA 1:** Këshilli, gjatë shqyrtimit të dosjeve të nëpunësve civil dhe sipas deklarimeve të udhëheqësit të njesisë së burimeve njerëzore, ka gjetur se në Ministrinë e Infrastrukturës, gjatë vitit 2020 kanë qenë 17 pozita të lira të cilat janë ushtruar me ushtrues të detyrës, dhe tek shumica e këtyre vendimeve baza juridike e nxjerrjes së tyre kanë qenë dispozitat e nenit 30 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, vetëm në tri raste me dispozitat e Ligji Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, dispozitat e të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative .

Këshilli vlerëson së dispozitat e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, përkatësisht neni 18 paragrafi 5, neni 19 paragrafi 4 dhe neni 20 paragrafi 3 i referohen rasteve kur pozitat e punës janë të plotësuara me

nëpunës civil mirëpo në raste të caktuara kur nëpunësi civil përkohësisht nuk mund të ushtroje detyrën për arsye të ndryshme si p.sh gjendet në pushim vjetor, mjekësor, vizitë jashtë vendi, etj, zëvendësohet nga nëpunësi civil sipas kriterëve të përcaktuara me dispozitat e lartcekura ligjore.

Ndërsa dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 32 paragrafi 4 i referohet rasteve të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të nëpunësit civil të përhershëm, dhe ky zëvendësim mund të bëhet për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj, p.sh zëvendësimi i nëpunësit civil që gjendet në pushim të lehonisë, pushim pa pagesë, etj. Zëvendësimi në rastet e tilla bëhet përmes procedurave të pranimit që zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës.

Këshilli, duke marr parasysh se pozitat e punës kanë qenë të lira, konstaton se organi i punësimit gabimisht ka zbatuar ligjin material me rastin e plotësimit të pozitave të lira me zëvendësues duke u thirrur në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, dhe dispozitat e nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Plotësimi i pozitave të lira është dashur të bëhet përmes zhvillimit të procedurave të lëvizjes brenda kategorisë apo ngritjes në detyrë siç përcaktohet me dispozitat e nenit 38 dhe 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Deri në plotësimin e vendit të lirë, organi i punësimit ka mundur të zbatonte procedurat e transferimit të përkohshëm të nëpunësit civil në interes të institucionit, të përcaktuar në nenin 52 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

**Rekomandimi 1:** Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë Infrastrukturës, që t'i ndër marr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për eliminimin e shkeljeve të konstatuara në mënyrë që plotësimi i pozitave të lira të bëhet sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

## 2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Infrastrukturës ka përgatitur Planin e Personelit për vitin 2020, mirëpo gjatë këtij viti nuk është zhvilluar asnjë procedurë e rekrutimit apo avancimit për faktin se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka qenë i pezulluar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, deri më 09.07.2020.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

**Marrëveshjet për shërbime të veçanta:** Kolegji për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të punësuarve me marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të veçanta, ka konstatuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2020 ka pasur të angazhuar njëqind e njëmbëdhjetë (111) të punësuar me kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta, ku prej tyre pesëdhjetë e shtatë (57) të punësuar me marrëveshje për shërbime të veçanta kanë

qenë të lidhura për pozita të shërbimit civil. Lidhur me angazhimin e tyre nuk ka pasur asnjë procedurë të rekrutimit dhe po ashtu ka pasur tejkalim të afatit të kohëzgjatjes së këtyre kontratave.

Lidhur me këtë fushë Këshilli ka gjetur:

**E GJETURA 1:** Këshilli, gjatë shqyrtimit të dosjeve të të punësuarve me marrëveshje për shërbimeve të veçanta, ka gjetur se këto kontrata janë lidhur në kohën kur në zbatim ka qenë Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe i gjithë procesi është dashur të ndiqet sipas këtij ligji. Këshilli ka konstatuar se për lidhjen e këtyre marrëveshjeve nuk është zhvilluar asnjë procedure nga Njësia për Burime Njerëzore. Për me tepër pesëdhjetë e shtatë (57) marrëveshje për shërbime të veçanta kanë qenë të lidhura për pozita të shërbimit civil dhe në shumicën e rasteve këto marrëveshje kanë qenë të lidhura për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj, në kundërshtim me nenin 12 paragrafin 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Me nenin 84 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil Nr.03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik.

Andaj meqenëse marrëveshjet sipas të gjeturave nuk janë të vlefshme pas kalimit të afatit për të cilën janë lidhur, dhe duke marr parasysh rregullativën e re ligjore nuk është dhënë rekomandim lidhur me këtë çështje.

### 3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Infrastrukturës, në bazë të Vendimit me Nr.Prot:5037 të datës 09.07.2020 e ka tërmeteluar Komisionin Disiplinor me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar, po ashtu është edhe Vendimi me Nr.Prot.6262 i datës 31.08.2020 për themelimin e Komisionit Disiplinor me përbërje prej tre (3) anëtarëve dhe me mandat tre (3) vjeçar.

Në këtë fushë Kolegji për monitorim ka gjetur:

**E GJETURA 1:** Kolegji për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjetur se Ministria e Infrastrukturës në baze të Vendimit me Nr.Prot:5037 të datës 09.07.2020 e ka themeluar Komisionin Disiplinor me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar i cili për bazë ka pasur Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, mirëpo i cili vendim nuk është shfuqizuar me nxjerrjen e Vendimit me Nr.Prot.6262 të datës 31.08.2020 me të cilin është themeluar Komisioni i ri Disiplinor përbërje prej tre (3) anëtarëve dhe me mandat tre (3) vjeçar sipas Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ministria e Infrastrukturës përmes Vendimit me Nr.Prot.6262 të datës 31.08.2020 ka themeluar Komisionit e ri Disiplinor, me mandat 3 vjeçar. Në vendimin mbi themelimin e Komisionit Disiplinor, nuk janë përshkruar pozitat e kryesuesit dhe anëtarëve të këtij komisionit. Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në nenin 49 paragrafi 5 ka përcaktuar që Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për themelimin, përbërjen, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor, kështu që me Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë janë miratuar rregullat e hollësishme për këtë fushë, ku neni 10 ka përcaktuar mënyrën e themelimit të Komisionit Disiplinor. Me nenin 10 paragrafi 2 përcaktohet se: “Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje: *Nëpunës civil i nivelit drejtues - Kryesues i Komisionit; Nëpunës civil i nivelit profesional –anëtar dhe Nëpunës civil i njësisë së burimeve njerëzore – anëtar*”. Meqenëse kjo dispozitë ka përcaktuar profesionin dhe nivelet e pozitave Ministria e Infrastrukturës në aktin e themelimit të Komisionit Disiplinor duhet të përshkruaj edhe pozitat dhe profesionin e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Disiplinor.

**Rekomandimi 1:** Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, që të ndërmerret të gjitha veprimet procedurale për plotësim/ndryshimin e vendimit mbi themelimin e Komisionit Disiplinor, dhe në vendim të shkruhet baza ligjore e emërimit të tij dhe të përshkruhen pozitat që mbajnë kryesuesi dhe anëtarët siç parashihet me nenin 10 të Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë si dhe të shfuqizohet vendimi me Nr.Prot.5037 i datës 09.07.2020 për themelimin e Komisionit Disiplinor.

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të deklaratës së Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore ka konstatuar se kanë qenë të iniciuara dhe të zhvilluara dy (2) raste në Komision Disiplinor dhe Komisioni Disiplinor për njërin rast ka shqiptuar masën disiplinore dhe për rastin tjetër nuk ka shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Kolegji për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të kërkesave për inicim të procedurës disiplinore ka gjetur se Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore me datë 13.04.2021 nëpërmjet e-mailit zyrtar e ka njoftuar udhëheqësin e drejtpërdrejtë, për nëpunësin i sistemuar në vendin e punës “Udhëheqës i Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm”, për mungesa të pa arsyeshme i cili ka munguar plotë njëqind e gjashtëmbëdhjetë (116) ditë dhe se gjatë kohës së mungesës në punë nuk e ka njoftuar Zyrën e personelit për mungesë në vend të punës. Ndërsa nëpunësi me datë 21.12.2020 me numër të protokollit 10133 e njofton Udhëheqësen e Burimeve Njerëzore se me leje të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës ka munguar për shkaqe shëndetësore duke ia bashkangjitur edhe dëshmitë nga mjeku.

**E GJETURA 2:** Kolegji për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit, të kërkesës për inicim të procedurës disiplinore dhe dëshmimeve të ofruara ka gjetur se nëpunësi i sistemuar në vendin e punës “Udhëheqës i Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm”, ka munguar në vendin e tij të punës për arsye shëndetësore mirë po i njëjti nuk i ka arsyetuar mungesat nga vendi i tij i punës në pajtim me procedurat ligjore që janë të përcaktuara me nenin 11 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë rrjedhimisht

Kolegji konstaton se nëpunësve civil iu takojnë njëzet (20) ditë punë brenda një (1) viti pushim mjekësor dhe nga dosja e prezantuar nuk kemi gjetur dëshmi se nëpunësi ka parashtruar kërkesë për pushim mjekësor për arsyetim të ditëve e po ashtu as nuk ka paraqitur kërkesë për pushim pa pagesë pasi që me legjislacion nëpunësve ju takojnë vetëm njëzet (20) ditë punë brenda një (1) viti pushim mjekësor.

**Rekomandimi 2:** Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm, që të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale që rasti të trajtohet në Komision Disiplinor dhe në bazë të kompetencës që ka Komisioni Disiplinor të bej shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura dhe të vendosë në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publik, Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë.

#### 4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, ka konstatuar se deri në hyrjen në fuqi të Ligjit Nnr.06/LP-114 për Zyrtarët Publikë (datë 09.07.2020) në Ministrinë e Infrastrukturës ka qenë duke funksionuar Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave. Në vitin 2020 janë trajtuar dymbëdhjetë (12) ankesa, ku 10 prej tyre janë refuzuar si të pa bazuara, një ankesë është aprovuar, ndërsa për një ankese Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka vendosur për përfundimin e procedimit administrativ .

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

#### 5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Infrastrukturës, nuk është bërë vlerësimi i rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civil edhe pse Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore me datë 23.11.2020 nëpërmjet e-mail-it zyrtar ka njoftuar të gjithë udhëheqësit për vlerësim të nëpunësve civile që vlerësimi të duhet të bëhet deri me 31 dhjetor 2020, mirëpo edhe për kundër njoftimit shtatëdhjetë e katër (74) nëpunësve civil nuk ju është bërë vlerësimi.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, po ashtu ka konstatuar se në vitin 2020 Ministria e Infrastrukturës, ka bërë vlerësimin e periudhës provuese për dy (2) nëpunës civil.

Lidhur me procedurën e vlerësimit kemi gjetur:

**E GJETURA 1:** Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në dosjet personale ka konstatuar se për shtatëdhjetë e katër (74) nëpunës civil të



Ministrisë së Infrastrukturës nuk është bërë vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 edhe pse Njësia për Burime Njerëzore pranë Ministrisë së Infrastrukturës, me datë 23.11.2020 nëpërmjet e-mail-it zyrtar iu ka përcjell shkresën menaxhereve drejtues dhe i ka njoftuar se vlerësimi i rezultateve të punës duhet të bëhet deri më datë 31.01.2021.

Në këtë rast mos vlerësimi i rezultateve të punës për të gjithë nëpunësit civil është shkelje e dispozitave të 43 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullore Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka përcaktuar që Zyrtarët Publikë duhet t'i ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësit konform këtij ligji, në këtë rast mos vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civil është mos përmbushje e detyrave të punës nga menaxherët drejtues.

**Rekomandimi 1:** Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës që t'i ndërmarr te gjitha veprimet e nevojshme ligjore në mënyrë që të sigurohet se të gjithë nëpunësit civil janë vlerësuar nga menaxheret drejtues siç përcaktohet me dispozitat e nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullore Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

**E GJETURA 2:** Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se për dy (2) nëpunës civil është kryer vlerësimi i periudhës provuese, mirëpo nga vlerësimi i dosjeve të nëpunësve civil të punësuar në pozitën pozitën “Zyrtare për Buxhet dhe Financa” dhe “Zyrtare Administrative”, kemi konstatuar që Akt Emërimi i nëpunëses për vendin e punës “Zyrtare për Buxhet dhe Financa” është nënshkruar me datë 19.07.2019 ndërsa më datë 21.12.2020 është nënshkruar formulari për vlerësimin e punës provuese, kështu që Kolegji ka konstatuar që nuk janë respektuar afatet për vlerësim të punës provuese siç parashihet me Kapitullin III respektivisht nenin 37 dhe 38 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit për monitorim po ashtu gjatë vlerësimit të dosjes së nëpunëses të punësuar në vendin e punës “Zyrtare Administrative”, ka konstatuar se nëpunësja me datë 29.07.2019 ka nënshkruar akt emërimit ndërsa me datë 26.08.2019 ka nënshkruar ndryshim dhe plotësimin e aktit të emërimit në vendin e punës “Zyrtare e Prokurimit” në kuadër të Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, i cili ndryshim dhe plotësim i akt emërimit ka rrjedh si rezultat i transferimit, ndërsa Formularin për vlerësimin e periudhës provuese e ka nënshkruar me datë 09.11.2020, kështu që Kolegji ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 20 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që ka përcaktuar se: *Të gjithë kandidatët që pranohen në Shërbimin Civil në pozitë e karrierës emërohen në punë provues me kohëzgjatje dymbëdhjetë (12) muaj. Në përfundim të periudhës së punës provuese, eprori i drejtpërdrejtë në bazë të vlerësimit pozitiv të performancës, mbështetur në rezultatet në punë të nëpunësit civil, vendos konfirmimin ose jo të tij në atë pozitë pune.*

**Rekomandimi 2:** Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësen e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Infrastrukturës, që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore në mënyrë që të sigurohen se në të ardhmen vlerësimi i periudhës provuese për nëpunësit e rinj të bëhet në pajtim me procedurën dhe afatet e përcaktuara me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Po ashtu Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm që ti ndërmarr veprimet për shfuqizimin e ndryshimit dhe plotësim të aktit të emërimit të datës 26.08.2019 për nëpunësen e sistemuar në vendin e punës “Zyrtare e Prokurimit”, pasi që ky ndryshim është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjor që kanë qenë të aplikueshme.

## 6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Infrastrukturës, evidenca e pushimeve të nëpunësve civilë mbahet vetëm në kopje elektronike.

Gjithsejtë, gjashtëdhjetë e tre (63) nëpunës civil kanë realizuar pushimin mjekësor, ndërsa dy (2) nëpunësve civile ka realizuar pushimin e lehonisë, dhe në bazë të dokumenteve në dosje të nëpunësve civilë, është konstatuar që nëpunësit civil kanë sjell dëshmitë mjekësore dhe po ashtu bazuar në të dhënat e dosjeve të shqyrtuara rezulton se pushimet e lehonisë janë aprovuar paraprakisht me vendim, dhe mund të konstatojmë se janë respektuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

## 7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Infrastrukturës, gjatë vitit 2020 ka pasur dy (2) transferime të brendshme të përkohshme

Në bazë të shqyrtimit të dosjeve, gjegjësisht pas vlerësimit të Vendimit të datës 15.07.2020 dhe Vendimit të datës 02.10.2020, Kolegji ka konstatuara se në dy vendimet është cekur edhe përcaktuar edhe koha e transferit, andaj konstatohet që janë respektuar procedurat e parapara me Rregulloren Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

## 8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në vitin 2020 në Ministrinë e Infrastrukturës kanë qenë të punësuar dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë (266) nëpunës civil, prej tyre dyqind e njëzet e katër (224) nëpunës civil janë të nacionalitetit shqiptar, tridhjetë e katër (34) serb, katër (4) boshnjak, tre (3) turq dhe një (1) goran,.

Nga dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë (266) të punësuar me status të nëpunësit civil, gjashtëdhjetë e nëntë (69) janë të punësuar femra ndërsa njëqind e nëntëdhjetë e shtatë (197) janë meshkuj, ndërsa në këtë institucion një (1) nëpunës civil është i punësuar me aftësi të kufizuara.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar edhe numrin e të punësuarve në aspektin gjinor dhe ka konstatuar këtë të gjetur:

**E GJETURA 1:** Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, se prej dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë (266) të punësuar me status të nëpunësit civil, gjashtëdhjetë e nëntë (69) janë të punësuar femra ndërsa njëqind e nëntëdhjetë e shtatë (197) janë meshkuj, çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve në aspektin gjinor ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

**Rekomandim 1:** Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

**E GJETURA 2:** Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë (266) nëpunësve civil të punësuar në Ministrinë e Infrastrukturës, është i punësuar vetëm një person me aftësi të kufizuara, me çka nënkuptohet se ky institucion nuk ka respektuar dispozitën e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, sipas të cilës dispozitë është përcaktuar që „Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor”.

**Rekomandimi 2:** Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, që të ndërmarr veprimet e duhura ligjore në mënyrë që t’ju jepet mundësia e punësimit personave me aftësi të kufizuara dhe të plotësohet kuota e përcaktuar me nenin 12 të Ligjit Nr.03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

## **9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS**

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Ministrinë e Infrastrukturës gjatë vitit 2020, nuk ka pasur asnjë nëpunës të pezulluar mirëpo nga vitet parapraket në këte institucion janë gjashtë (6) nëpunës civil me pezullim parandalues .

Kolegji po ashtu ka konstatuar se një (1) nëpunësi civil i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të njëanshme si rezultat i dorëheqjes dhe në bazë të vlerësimit të dosjes lidhur me këtë rast ka pasur deklarate për dorëheqje nga nëpunësi civil, kurse me datë 06.01.2020 është nxjerrë Vendimi me numër protokollit 01/40 nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës.

Në këtë institucion tetë (8) nëpunësve civil iu është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit për të cilët janë nxjerr vendime për përfundim të marrëdhënies së punës si dhe iu është bërë kompensimi material me rastin e pensionimit. Po ashtu në këtë institucion dy (2) nëpunës civilë kanë vdekur dhe familjarëve iu është bërë kompensimi/pagesa e një page të njëhershme në vlerë të një page mujore.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

## **10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK**

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të marra si mostër dhe sipas deklaramit të udhëheqësit të njësisë përgjegjëse ka konstatuar se në Ministrinë e Infrastrukturës në gjatë vitit 2020 nuk ka pasur raste ku nëpunësi civil në të njëjtën kohë mbanë pozitë të shërbimit civil dhe ndonjë post tjetër publikë.

Në këtë fushë të monitorimit nuk është gjetur shkelje dhe rrjedhimisht nuk janë dhënë rekomandime.

## **11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS**

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të informatave të pranuar nga zyrtarët e personelit, ka konstatuar se në Ministrinë e Financave nuk është duke u zhvilluar asnjë procedurë penale ndaj ndonjë nëpunësi civil, po ashtu nuk ka asnjë nëpunës civil që është dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

## **12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL**

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Infrastrukturës ka përgatitur planin individual të trajnimeve në të cilin përfshihen fushat e trajnimit. Plani i trajnimit në këtë institucion është përgatitur me datë 16.01.2020 dhe në të njëjtën datë është dorëzuar në MAP/DASHC, dhe i njëjti ka filluar të zbatohet përmes pjesëmarrjes së nëpunësve civil në trajnimet e organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike. Evidencat e trajnimeve mbahen në kopje fizike dhe elektronike.

Në këtë fushë të monitorimit nuk është gjetur shkelje dhe rrjedhimisht nuk janë dhënë rekomandime.

## **13. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE KALSIFIKIMI I VENDEVE TË PUNËS**

Ministria e Infrastrukturës ka në fuqi Rregulloren (QRK) Nr.16/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të vitit 2015 e cila është e zbatueshme.

## **14. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET**

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Infrastrukturës, prezenca në punë e nëpunësve civil evidentohet përmes sistemit elektronik.

Sipas deklaramentit nga Udhëheqësja e Personelit dhe në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohen në pajtim me Akt Emërimet. Ndërsa sa i përket shtesave është konstatuar që nëpunësve civil i është bërë kompensimi i përcaktuar me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

## **15. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT**

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se gjatë vitit 2020 Ministria e Infrastrukturës ka pranuar katër (4) vendime nga Këshilli dhe se të gjitha vendimet e Këshillit janë zbatuar nga Ministria e Infrastrukturës.

Ministria e Infrastrukturës në vitin 2018 është monitoruar për vitin 2017 mirëpo nuk është miratuar raporti për shkak që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil i Kosovës ka qenë jo funksional

## 16. NGACMIMET SEKSUALE

Gjatë vizitës së monitorimit nuk na është raportuar asnjë rast në këtë fushë dhe për këtë nuk kemi të gjetur dhe rekomandim.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

## 15. SHËNIMET/KOMENTET PËR MIBKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit me rastin e mbikëqyrjes së të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes në Ministrinë e Infrastrukturës, ka arritur të konstatoj shtatë (7) të gjetura dhe ka dhënë shtatë (7) rekomandime, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Ministrisë së Infrastrukturës, që *gjetjet me rekomandimet* e dhëna në këtë raport t'i adresojnë dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojnë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

### Raporti i dërgohet:

- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës;
- ❖ Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Infrastrukturës; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK.